



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:001121
Datë: 03.02.2023
Numri i dokumentit: 03935175

PKR.nr.11/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, sipas kryetares së trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj, me bashkëpunëtoren profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit M. Z., për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së*, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda nën shenjën PP/L.nr.327/22 të datës 17.01.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 02.02.2023, në prezencë të Prokurores së Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit M. Z., dhe mbrojtësit të tij av. G. K., në të njëjtën ditë bie dhe shpall, ndërsa me datë 03.02.2023, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **M. Z.**, nga i ati F. dhe e ëma A., gjinisë M., i lindur me në fshatin, Komunë Pejë, me vendbanim në rr., nr.15, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes ekonomike, me numër personal lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me parë e gjerë me datë 17.12.2022 rreth orës 12:30 në rr.në Pejë, në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit për Armë, ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar dhe atë: një (1) pistoletë “Zastava” kalibër 6.35mm, me numër serik ET911243, dy (2) karikator, katër (4) fishek kalibër 6.35mm, një (1) pistoletë “Ekol Special 99”, kalibër 9mm, me numër serik EV-1070367, tre (3) fishek kalibër 7.65mm, në atë mënyrë që, përderisa i pandehuri ishte në veturë të tipit “Golf VI”, me targa me dëshmitarin A. M., ku ki i fundit e drejtonte veturën, ndalohen nga policia për tejkalim shpejtësie, ku gjatë kontrollit i njëjti i paraqet se ka në posedim armët si më lartë, me ç ‘rast të njëjtat i sekuestrohen nga policia.

-Me çka ka kryer veprën penale *Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.*

Andaj, në aplikim të nenit 7, 17, 38, 39, 40 par.1 nënpar.1.3, 43, 69 par.3 lidhur me par.1, pika 3.5, 3.6, 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-së, 360, 365, 366, 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6, të KPPRK-së, të njëjtin e:

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej **tetëqind (800) €**.

Obligohet i pandehuri, që dënimin me gjobë në shumë prej tetëqind (800) €, ta paguaj me këste në afat prej tre (3) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke filluar nga data 01 deri me datën 05, të çdo muaj vijues.

Mundësia e pagesës me këste, do të revokohet nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën në tërësi, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgim me 20 € gjobë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej njëzet (20) € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së,

KONFISKOHET një (1) pistoletë “Zastava” kalibër 6.35mm, me numër serik ET911243, dy (2) karikator, katër (4) fishek kalibër 6.35mm, si dhe një (1) pistoletë “Ekol Special 99”, kalibër 9mm, me numër serik EV-1070367, tre (3) fishek kalibër 7.65mm, sipas vërtetimit për sekuestrim të përkohshëm të sendeve me numër të rastit 2022-DA-2267 të datës 17.12.2022.

URDHËROHET që një (1) pistoletë “Zastava” kalibër 6.35mm, me numër serik ET911243, dy (2) karikator, katër (4) fishek kalibër 6.35mm, dhe një (1) pistoletë “Ekol Special 99”, kalibër 9mm, me numër serik EV-1070367, tre (3) fishek kalibër 7.65mm, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.

A r s y e t i m

Historiku i rastit.

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/I.nr.327/22 të datës 17.01.2023, kundër të pandehurit M. Z., për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së*.

Lënda në punë është pranuar me datë 20.01.2023.

Me datë 01.02.2023, është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar.

Prokurorja e Shtetit, konform nenit 244 par.3 të KPPRK-së, ka përmbushur obligimin lidhur me sigurimin e materialit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

I pandehuri në aplikimi të nenit 246 par.1 të KPPRK-së, është njoftuar me të drejtat e tij dhe për mbrojtës është deklaruar se nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës, Kryetarja e trupit gjykues, është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, dhe i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e udhëzuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimi të fajësisë, siç përcakton dispozita e nenit 248 par.1 të KPPRK-së.

I pandehuri M. Z., e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, i vetëdijshëm për pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare pa presion nga askush.

Kryetarja e trupit gjykues ka marrë mendimin nga Prokurorja e Shtetit dhe mbrojtësi i tij, të cilët janë pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasur parasysh se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat të cilat i janë bashkangjitur aktit akuzues.

Sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 257 të KPPRK, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa-pranueshme, nuk ka gjetur arsye për hedhje të aktakuzës, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale për të cilën akuzohet. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të cilat janë parashtruar me aktin akuzues e për të cilat i pandehuri ka qenë i njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale dhe të njëjtat nuk i ka kundërshtuar.

Në këtë rast është vlerësuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, dhe në aplikim të nenit 248 par.4 të KPPRK-së, Kryetarja e trupit gjykues, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri Z..

Konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar me seancën për caktim të dënimit.

Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin i ka propozuar gjykatës që për të pandehurin si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, faktin se nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën e re, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Mbrojtësi i të pandehurit M. Z., av.G. K., me rastin e marrjes së vendimit për dënimin i ka propozuar gjykatës që përveç rrethanave si më lartë, të merre parasysh dhe faktin se i njëjti është penduar thellë për veprimet e ndërmarra, dhe në mbështetje të këtyre rrethanave të njëjti t'i shqiptoj një dënim sa me të butë.

I pandehuri M. Z., e ka mbështetur në tërësi deklarin e mbrojtësit të tij.

Gjykata, erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK, si dhe faktet e provat që përmban akti akuzues, ku në veprimet e të pandehurit M. Z. formohen të gjitha elementet e veprës penale *Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së*, ku për këtë gjykata të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 69 par.1 pika 3.5, 3.6 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në gjitha fazat e procedurës, faktin se nuk ka qenë i dënuar më parë, si dhe pendimin e tij për veprimet e ndërmarra.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.1 të KP-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë së tij, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin u mor konform nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.11/23

Bashkëpunëtore profesionale
Elzana Kastrati

Kryetarja e trupit gjykues
Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate